VENDIM
Nr. 114, datë 9.7.2020

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME NGA ERA, ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 3 mw, PËR VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; VKM-së nr. 369, datë 26.4.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era"; VKM-së nr. 580, datë 28.8.2019, "Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë 2019–2020" dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 83/3 prot., datë 3.7.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi miratimin e çmimit të blerjes të energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet eolike, me kapacitet të instaluar deri në 3 mw, për vitin 2019,

konstatoi se:

- Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era", ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli, me fuqi të instaluar deri në 2 mw, dhe era, me fuqi të instaluar deri 3 mw, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 193, datë 2.12.2019, vendosi fillimin e procedurës "Për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli, me fuqi të instaluar deri në 2 mw, dhe era, me fuqi të instaluar deri 3 mw, për vitin 2019".

- Në vijim, ERE, me shkresën nr. 805, datë 10.12.2019, njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetin e Konkurrencës (AK) dhe palët e interesuara, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e këtij akti, me qëllim shprehjen e komenteve apo opinioneve të tyre me shkrim, brenda 15 ditëve nga marrja dijeni.

- Në përgjigje të njoftimit të kësaj vendimmarrjeje, shoqëritë të cilat janë mbajtëse të miratimit përfundimtar dhe subjekte të aplikimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga era, me fuqi të instaluar 3 mw, i cili përcaktohet nga ERE, kanë dhënë opinionin dhe shpjegimet e tyre në lidhje me mungesën e zhvillimit të industrisë së prodhimit të energjisë elektrike nga era në Shqipëri, ku ndër të tjera janë shprehur se: …*të dhënat e llogaritura dhe përpunuara në studimin e fizibilitetit, para momentit të marrjes së miratimit përfundimtar nga MIE lidhur me vlerën e investimit, janë të dhëna të kësaj faze dhe që nuk mund të merren për referencë në vlerësimin e çmimit nga ana e Bordit të ERE-s.*

- Autoriteti i Konkurrencës, me anë të shkresës së protokolluar në ERE me nr. 434, datë 18.2.2020, është shprehur se vendimi nr. 193, datë 2.12.2019, i Bordit të ERE-s, nuk bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar.

- Në vijim të sa më sipër, ERE, me anë të shkresës nr. 58/1, datë 17.1.2020, i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ku ndër të tjera ka kërkuar vlerësimet dhe

opinionin e saj në lidhje me sa argumentuar nga të 3 shoqëritë në korrespondencat sipërcituara, si dhe disponimin e dokumentacionit që i ka shërbyer MIE-s për dhënien e miratimit përfundimtar.

- MIE, me anë të shkresës së protokolluar në ERE me nr. 58/2, datë 4.3.2020, ka përcjellë në ERE planet e biznesit të shoqërive mbajtëse të miratimit përfundimtar, gjithashtu ndër të tjera i ka dhënë përgjigje dhe rrethanave të bëra me dije nga këto subjekte.

- Shoqëritë "Windsbab" sh.p.k., "Max Energy" sh.p.k. dhe "Seman Eolik" sh.p.k. janë të vetmet shoqëri që kanë marrë miratimin përfundimtar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për vitin 2019, për ndërtimin e impianteve eolike me fuqi deri në 3 mw;

- Pavarësisht numrit të licencave të dhëna ndër vite për ndërtimin e impianteve eolike në Shqipëri, këto shoqëri po implementojnë për herë të parë këtë teknologji, duke sjellë diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, me investime me kosto më të ulët nga sa parashikuar në VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017, dhe VKM-në nr. 580, datë 28.8.2019.

- Për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, nga era, me fuqi deri në 3 mw, për vitin 2019, është e arsyeshme të njihen komponentët për llogaritjen e LCOE-ve që rezultojnë nga planet e biznesit të projekt zbatimeve të paraqitura së fundmi nga 3 shoqëritë të cilat janë mbajtëse të miratimeve përfundimtare për ndërtimin e impianteve eolike.

- Në zbatim të sa më sipër dhe nisur nga eksperienca e krijuar për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet prodhuese fotovoltaike deri në 2mw, është përllogaritur çmimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 mw.

- Nga zbatimi i formulës për llogaritjen e LCOE-ve, për përcaktimin e çmimit për impiantet eolike, rezulton një çmim prej 75.64 euro/mwh.

- Në kontratat respektive midis palëve e më konkretisht nenit 8, pika 2 dhe nenit 10, pika 4, vlerësimi i investimeve mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve, në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit për ndërtimin e parkut eolik, si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), bazuar në raportin përfundimtar të testimit dhe pas paraqitjes nga mbajtësit e miratimit përfundimtar të raportit të plotë të shpenzimeve për ndërtimit e veprës, lëshon certifikatën e pranimit të veprës sipas legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet eolike, me kapacitet të instaluar deri në 3 mw, prej 75.64 euro/mwh, për vitin 2019.

2. Çdo ndryshim në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këta prodhues, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga ERE.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë aplikuesit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetin e Konkurrencës (AK), si dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL sh.a.) për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti